



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 231 Prot.

Tiranë, më datë 05.07.2019

VENDIM

Nr.243, datë 05.07.2019

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT ZHVILLIMOR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48, pika 1 dhe neni 134, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 05.07.2019, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Ndërtimi hidrocentraleve në lumin Gostimë (Egnatia-Shushicë)”, Qarku Elbasan, me subjekt aplikues shoqëria “EGNATIA HYDROPOWER” sh.p.k.,
- *Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture: “Ura e Gurit” në fshatin Qukës, Bashkia Përrenjas;*
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 144-147;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elva MARGARITI

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani

